

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Zhvillimi dhe mirëmbajtje e Sistemit të Menaxhimit të Tregut për një periudhë 1 (një) vjeçare”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

30211300-4 - Platforma kompjuterike

72267100-0 - Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit

VLERA E FONDIT LIMIT:

20,765,490 (njëzet milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën 216,690.91 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë pike nëntëdhjetë e një) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 09.04.2026 (1 EUR = 95.83 ALL).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Zhvillimi dhe mirëmbajtje e Sistemit të Menaxhimit të Tregut për një periudhë 1 (një) vjeçare”, ka për qëllim krijimin e nje platforme te re si dhe mirembajtjen e sistemit per menaxhimin e tregut per nje periudhe 1 vjecare. Ky proces do te kryhet sipas Termave të Referencës përshkruar në Dokumentet e Tenderit.

Ndarja e kësaj procedure në Lote dhe rrjedhimisht mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, do të vështirësonte realizimin e kontratës, pasi operatorët ekonomikë të ndryshëm mund të paraqiten me oferta të cilat nuk përputhen me njëra-tjetrën, me qëllim mirëmbajtjen dhe konfigurimet përkatëse të kërkuara për këtë procedurë.

Për këtë arsye, ndarja në Lote e kësaj procedure është e pamundur dhe duhet të zhvillohet si një procedurë prokurimi e vetme.

Autoriteti Kontraktor është institucion i rëndësisë së vecantë në sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe cdo vonesë në realizimin e kontratës mund të shkaktojë dëme të mëdha në rrjetin e transmetimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 41,000,000 (dyzet e një milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate sasine dhe cilesine e mallrave, si dhe sherbimet objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros per tre vitet e fundit financiare te jete ne masen 41,000,000 (dyzet e një milion) Leke, jo me e larte se dyfishi i vleres se parashikuar te kontrates, sipas parashikimeve te nenit 43/2/a te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 8,000,000 (tetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e sherbimeve të realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të e sherbimeve të realizuara.

Shenim: Per shkak te kompleksitetit te kesaj procedure prokurimi, kontrata te ngjashme do te kosniderohen ato qe kane ne perberje implementim te modulit te Skedulimit, modulit te Balancimit dhe Transparences.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave si dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues për të bërë të mundur kryerjen e këtij shërbimi duhet të ketë në stafin e tij të pakten 2(dy) inxhinierë IT.*

Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë:

i) listepagesat ose cdo dokument tjetër që të provojë se janë punonjës të operatorit ekonomik;

ii) CV-të, diplomat dhe kontratat e punës për punonjësit e sipërcituar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter lidhet ngushtesisht me specifikimet teknike për shërbimin e kërkuar. AK duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar i cili të përgjigjet me së miri nevojave të kërkuara në këtë procedure.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/suportin e prodhuesit/ve ose distributoreve të autorizuar për realizimin e kontratës objekt procedure prokurimi. Dokumenti i leshuar nga prodhuesi/distributori i autorizuar duhet të përmbajë të dhënat e plota si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Suporti i prodhuesit/distributorit të autorizuar, është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave dhe shërbimeve. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo

prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 10 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe Termat e References, jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat dhe sherbimet objekt procedure prokurimi, duke perllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.